

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

## NDËRMJET

### MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### DHE

### MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E GJENDJES CIVILE

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë, më poshtë të referuara si "Palët":

Në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera që ekzistojnë mes dy vendeve;

Duke vepruar sipas interesit të ndërsjellë, me synim përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e gjendjes civile;

Duke vepruar sipas parimit të barazisë dhe interesit të ndërsjellë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, rregullat e procedurat e vendeve të tyre;

Kanë rënë dakord sa vijon:

### Neni 1

#### Objekti

Objekti i Memorandumit të Mirëkuptimit do të jetë realizimi i një bashkëpunimi për lehtësimin e procedurave të ofrimit të shërbimit të Gjendjes Civile.

### Neni 2

#### Fusha e bashkëpunimit

1. Palët angazhohen të ndërmarrin një rishikim të kornizës ligjore dhe mundësive me qëllim lehtësimin e procedurave të bashkëpunimit në fushën e gjendjes civile.
2. Palët shkëmbejnë informacion lidhur me statistikat në fushën e gjendjes civile. (akte të lindjeve, martesave, vdekjeve të ndodhura në shtetet palë të kësaj marrëveshje, shtetas shqiptarë të cilët fitojnë shtetësinë kosovare, shtetas shqiptarë me leje qëndrimit në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas.)

3. Palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e përvojave.
4. Palët bashkëpunojnë për trajnime të përbashkëta të stafëve përkatëse të të gjitha niveleve.
5. Palët rrisin nivelin e komunikimit, kontaktit dhe vizitave të ndërsjella.
6. Palët organizojnë takime, simpoziume, konferenca në fushën e gjendjes civile.

### **Neni 3**

#### **Format e bashkëpunimit**

1. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve kryhet në përputhje me legjislacionin shtetëror të shteteve.
2. Palët të përcaktojnë reciprokisht zyrtarë ndërlidhës për zhvillim të kontaktit.
3. Palët të përcaktojnë një pikë të vetme të kontaktit.
4. Palët do të zhvillojnë takime të paktën dy herë në vit në nivel drejtues për shkëmbim të përvojave ndër-institucionale.
5. Palët mund të ndërmarrin konsultime dhe takime pune në të gjitha nivelet për të diskutuar masat lidhur me zhvillimin e bashkëpunimit sipas këtij memorandum mirëkuptimi. .
6. Palët shkëmbejnë informacionin që merret gjatë procesit të punës dhe veçanërisht lidhur me çështjet dhe problematikat e punës mbi shtetasit e dy vendeve, me qëllim të bashkërendimit të punës dhe gjetjes së zgjidhjes për çështjet përkatëse.

### **Neni 4**

#### **Shkëmbimi i Informacionit**

1. Autoritetet kompetente të palëve ndihmojnë njëra tjetrën mbi bazë të kërkesës.
2. Kërkesat për dhënie asistence dhe përgjigjet e tyre përcillen me shkrim. Në rast emergjence, kërkesat mund të dërgohen verbalisht; të pasuara menjëherë brenda 24 orëve nga konfirmimi me shkrim, nëpërmjet përdorimit të mënyrave teknike për dërgimin e dhënave.

Kërkesa për marrjen e informacionit përmban:

- emrin e autoritetit kompetent kërkuar dhe autoritetin kompetent të kërkuar;
  - formulimin e thelbit të çështjes dhe arsytimit për të, si dhe informacionin mbi ekzekutimin e saj.
3. Informacionet dhe dokumentet të marra në përputhje me kushtet e këtij neni, nuk i dërgohen një palë të tretë, pa marrë miratimin paraprak me shkrim të palës dërguese.
  4. Në kuadrin e këtij memorandum mirëkuptimi, secila nga palët mund të refuzojë, plotësisht ose pjesërisht, një kërkesë për ndihmë nëse pala vlerëson se përmbushja e saj mund të kërcënojë sigurinë e të dhënave personale, informacionin konfidencial apo interesa tjera jetike dhe sigurisë, apo cenon detyrimet e saj që rrjedhin nga legjislacioni shtetëror apo marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë rast, pala e kërkuar njofton menjëherë palën kërkuese mbi refuzimin dhe jep informacion ose shpjegon arsyet e saj.
  5. Kërkesat mes palëve duhet të shqyrtohen sa më parë brenda 24 orëve në rastet kur mund të jepet informacioni, me afatin kohor maksimal për përgjigje 45 ditë për rastet komplekse.
  6. Në përputhje me këtë memorandum mirëkuptimi, shkëmbimi i informacionit të kufizuar kryhet në përputhje me legjislacionin shtetëror të secilës palë.

7. Të dhënat e dërguara duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet të cilat ato janë dhënë.

## Neni 5

### Bashkëpunimi lidhur me trajnimet

1. Palët do të organizojnë trajnime, konferenca, takime pune të përbashkëta në fushën e gjendjes civile. Palët duhet të organizojnë takime pune, minimumi një herë në vit.
2. Palët do ta pranojnë personelin e palës tjetër në programet trajnuese të ofruara për fushën e gjendjes civile.
3. Palët do t'i shkëmbejnë aktet nënligjore, procedurat, rregulloret, udhëzimet, standardet me shkrim, lidhur me ofrimin e shërimit të gjendjen civile.
4. Palët mund të shkëmbejnë ekspertë dhe zyrtarë të caktuar për trajnime, instruksione, ndihmë profesionale, ndihmë administrative, ndihmë teknike në kohë të caktuar lidhur me fushën e gjendjes civile.

## Neni 6

### Autoritetet Kompetente

1. Autoritetet kompetente të Palëve për zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi janë si më poshtë:

Për palën kosovare;

Ministria e Punëve të Brendshme

Agjencia e Regjistrimit Civil – ARC

Për palën shqiptare;

Ministria e Brendshme.

## Neni 7

### Shpenzimet

1. Të gjitha shpenzimet lidhur me kryerjen e aktiviteteve brenda kuadrit të këtij memorandumi mirëkuptimi, do të përballohen nga vetë palët.

## Neni 8

### Ndryshimet

1. Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë pas dakordimit të palëve përmes një note verbale e dërguar nëpërmjet rrugëve diplomatike.

## Neni 9

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij memorandum mirëkuptimi zgjidhet ndërmjet palëve me mirëkuptim.
2. Për zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi, autoritetet kompetente, nëse është e nevojshme mund të krijojnë grupe pune.

## Neni 10

### Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Ky memorandum mirëkuptimi është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar. Secila palë mund të njoftoje palën tjetër në çdo kohë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike rreth qëllimit të saj për të përfunduar marrëveshjen, 3 muaj para mbarimit të afatit.

Ky Memorandum Mirëkuptimi nënshkruhet më 20.06.2017 në Prishtinë, në dy origjinale secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike dhe njëloj të barasvlershme.

Në rast mosmarrëveshje në interpretimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme të  
Republikës së Kosovës

**Xhelal SVEÇLA**

Për Ministrinë e Brendshme të  
Republikës së Shqipërisë

**Bledar ÇUÇI**